



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

**VENDIM**

**Nr. 18/2018**

**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR,  
SIPAS LIGJIT NR. 115/2016 “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT  
TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të pikës 8 të nenit 147 të Kushtetutës dhe të pikës 16 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

I. Të konsiderojë të zgjedhur kandidatët e listës së tretë në bllok për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që ka rezultuar nga hedhja e shortit në nënkomisionin “Për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, për shkak të mosarritjes së shumicës prej dy të tretave të votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, si vijon:

1. Fatmira Luli (nga avokatia)
2. Alban Toro (nga avokatia)
3. Erjon Muharremaj (nga trupa e pedagogëve)
4. Maksim Qoku (nga trupa e pedagogëve)
5. Naureda Llagami (nga shoqëria civile).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Gramoz RUÇI**

Miratuar në datën 8.2.2018